

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 SHTATOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 25. SEPTEMBRA 2003.

Shtator – Septembar
2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e financave publike (2003/25),
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet (2003/26).

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о измени и допуни Закона о менаџирању јавним финансијама (2003/25),
3. Прво разматрање Нацрта закона о пестицидима (2003/26).

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on changing and completing of the Law on Management of Public Finance (2003/25),
3. First reading of the Draft Law on aw on pesticide (2003/26).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR 25 SHTATOR 2003

Seanca Plenare u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal – Prishtinë.

SEANCËN E KRYESOI, FATMIR SEJDIU, ANËTAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES, GOJKO SAVIQ, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

Seanca filloi punën në orën 10,15.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të nderuar kolegë deputetë, mirëseerdhët në Seancën e sotme.

Sipas informacioneve që kemi nga Sekretaria, ekziston numër i mjaftueshëm i deputetëve në sallë dhe mund të fillojmë me punën.

Siç e keni marrë bashkëngjitur me thirrje, rendi i ditës për mbledhjen e sotme, është:

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet.

Prezent sot kemi edhe dy nga ministrat e Qeverisë së Kosovës që do të paraqesin ekspozetë për dy projektet, të parin dhe të dytin.

A pajtoheni me këtë rend të ditës?

Piksëpari të them se ekziston një konstatim i përbashkët që jemi pajtuar në seancën e kaluar. Një ndryshim i vogël është bërë në ndërkohë, në bazë të propozimeve të dhëna atë ditë në seancë. Është fjala për tërheqjen e një shqyrtimi të mëtejshëm të ligjit për shkak se grupet parlamentare, përkatësisht komisionet parlamentare nuk janë bërë të gatshme dhe është futur sipas propozimit po ashtu në seancën e kaluar dhe kjo është një marrëveshje, gjithashtu interne me shumicën e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit. Urdhëroni zotri Luzha.

BERAT LUZHA:

Zotëri kryesues, të nderuar deputetë,

Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kemi debatuar për situatën politike në Kosovë, me theks të veçantë për bisedimet e paralajmëruara me Serbinë. Debati u ndërpre, kurse nuk u miratua asnjë dokument, madje as konkluzionet nga kjo mbledhje, por ishte kërkesë që të miratohej një deklaratë apo një dokument tjetër.

Në këtë mbledhje, për habi, mungon kryetari i Kuvendit, siç mungojnë edhe kryetarët e grupeve parlamentare kryesore. Konsiderojmë se kemi të bëjmë me ikjen nga përgjegjësia në këtë gjendje shumë të vështirë, kurse në emër të Kuvendit mundësohet të flasin njerëz të paautorizuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron se Kuvendi duhet ta kryejë detyrën e vet: të miratojë një platformë e cila do t'u shërbejë institucioneve tona për bisedime. Para se gjithash duhet të mbizotërojë arsyeja te deputetët, në mënyrë që bisedimet t'mos na zënë të papërgatitur dhe pa qëndrime të harmonizuara institucionale. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Vetëm një sqarim. Në seancën e kaluar, ka mbet për obligim që përfundimet nga debati dhe nga ajo pjesë e diskutimeve që i janë bashkëngjitur Sekretarisë dhe Kryesisë së Kuvendit të hartohen apo të nxirren përfundime të caktuara. Besoj se në një nga seancat e ardhshme, s'mund të them në seancën e ardhshme, por - në një nga seanca të ardhshme, adekuat kohës, do të bëhet kjo. Ju falemnderit.